



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:042650
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05701879

CA.nr.4448/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Naim Mehulli anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit të masës së sigurimit B..... A..... nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. J.... H..... nga shoqëria e avokatëve “DeJure Laë Firm”, kundër të paditurës – kundërpropozueses Trepça Sh.A me seli në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A..... V....., me objekt të kontestit anulim i vendimit, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit-propozuesit të masës së sigurisë, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.661/2024, të datës 06.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **17.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit të masës së sigurimit B..... A..... nga Mitrovica, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.661/2024, i datës 06.03.2024, **VERTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar C.nr.661/2024, të datës 06.03.2024 ka vendosur si vijon: **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësit – propozuesit B.....A.....nga Mitrovica e paraqitur kundër të paditurës Trepça Sh.A., me seli në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i vendimit nr.243 i datës 11.01.2024. Procedura në këtë çështje juridike-kontestimore, do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

Kundër këtij Aktvendimi brenda afatit ligjor paditësit-propozuesi i masës së sigurisë, përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të ndryshohet Aktvendimi i atakuar duke aprovuar masën e sigurimit të kërkesëpadisë apo të njejtin ta prishë dhe kthen lëndën në rigjykim dhe rivendosje.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit–propozuesit të masës së sigurimit, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 06.02.2024 ka parashtruar padi, kundër të paditurës, për anulim të vendimit Nr.243 të datës 11.01.2024 dhe njëkohësisht propozim për masë të sigurimit të kërkesëpadisë.

Gjykata e Shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të propozuesit, ka nxjerrë Aktvendimin e atakuar. Në arsyetim të Aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se lidhur me kushtin e parë i cili kërkohet si kusht për caktimin e masës së sigurisë, që ka të bëjë me besueshmërinë e të drejtës subjektive gjykata vjen në përfundim se propozuesi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës, nuk bëhen të besueshme faktet se kundërshtari i sigurimit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe plotësim ndryshimeve të tij. Lidhur me kushtin e dytë, duke vendosur sipas propozimit të paditësit në fjale, të datës 06.02.2024, me të cilin propozim pala propozuese ka kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i vendimit nr. 243 të dt.11.01.2024, gjykata të njëjtin propozim e refuzoj si të pa bazuar, duke marrë parasysh se në rastin konkret palës paditëse-propozuese nuk do t'i pamundësohej realizimi i të drejtës apo në një mënyrë do të ndikonte negativisht në të drejtat e palës së lartcekur, nëse do të vazhdohej në procedurë të rregullt. Kjo Gjykate mori parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me kontest pune, kontest i cili ka prioritet ligjor, e që e njëjta çështje do të procedohet me urgjencë brenda kësaj gjykate, deri në përfundimin e saj. Për më tepër gjykata vlerëson se edhe pse është zgjedhur një person tjetër në pozitën në të cilën ka aplikuar edhe paditësi - propozuesi, këtij të fundit nuk do ti shkactohej asnjë dëm e as nuk do ti rrezikohej drejta e tij subjektive. Kjo për faktin se nëse gjatë shqyrtimit meritohet të kërkesëpadisë, rezulton se konkursi në fjalë dhe përzgjedhja e kandidatit në të cilën ka aplikuar edhe vet propozuesi, është zhvilluar në mënyrë të kundërligjshme, atëherë një procedurë e tillë do të anulohet dhe çështja e konkursit do të kthehet në pikën zero. Me dispozitën e nenit 304 par.3 të LPK-së, përcaktohet: *“Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës të sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë, po që se ka mundësi, që mjetet provuese t’ia bashkangjijtë propozimit.”*. Andaj, rrjedhimisht rezulton, se nevoja për caktimin e masës së sigurisë, nuk është argumentuar me prova relevante, të besueshme dhe bindëse nga ana e paditësit – propozuesit të masës së sigurimit. Gjykata thekson faktin se në rastin konkret, objekt shqyrtimi është vetëm vlerësimi i pretendimeve në lidhshmëri me plotësimin e kushteve për caktimin e masës së sigurisë në kuptim të nenit 297 par.1 pika a) dhe b) lidhur me nenin 306 të LPK-së dhe një vlerësim i tillë nuk e prejjudikon vendosjen e çështjes kryesore lidhur me kërkesëpadinë, e cila do të vendoset me rastin e procedimit të rregullt, pas ndërmarrjes së veprimeve të parapara procedurale, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të propozuara. Andaj, nga të lartcekurat, në mbështetje të dispozitave nga nenet 297,

lidhur me nenin 142 par.5 e lidhur me nenin 387 par.1 pika (l) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se paditësit–propozuesit i masës së sigurimit nuk e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se ka rezultuar se propozuesi i sigurimit nuk e ka argumentuar mjaftueshëm të drejtën e tij subjektive deri në këtë fazë të procedurës kontestimore. Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të paditësit – propozuesit të sigurimit lidhur me ekzistimin e të drejtës subjektive dhe rrezikun e mundshëm që do të ndokonte në të drejtat e tij dhe do t'i pamundësohet realizimi i të drejtës së tij, pa e prejudikuar përfundimin meritore të çështjes, në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik e gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurisë në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pa bazuara dhe se nuk ndikojnë që gjykata të marrë një vendim ndryshe. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Numri i lëndës: 2024:042650
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05701879

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CA.nr.4448/2024, datë 17.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi